



In medias res

Mësimdhënësit në funksion të zhvillimit njerëzor dhe të kapitalit social

“Edukatori për të edukuar, vetë duhet të jetë i edukuar”

Mësimdhënësit kanë qenë, janë dhe do të jenë shtylla e progresit, emancipimit, formimit të kombit dhe krijimit të shteteve të zhvilluara dhe humane. Në anën tjetër institucionet arsimore, çerdhet, kopshtet, shkollat fillore dhe të mesme, fakultetet, kolegjet dhe të gjitha organet, organizatat e një vendi duhet të jenë doemos *“farkëtari ku njeriu vërtet duhet të bëhet njeri”*. Shteti që mëton të jetë shtet i vërtetë, në të cilën do të sundon ligji i të drejtës, ku njerëzit do të ndjehen të lumtur dhe të vlefshëm, pavarësisht se si duken, sa të mençur janë, cilën gjuhë e flasin dhe cilit besim apo gjini i takojnë, moshës që kanë duhet të sigurojë një sistem arsimit i cili do të jetë në funksion të zhvillimit maksimal njerëzor dhe të kapitalit maksimal social. *Zhvillimi njerëzor dhe i kapitalit social, në masën më të madhe varen nga efikasiteti dhe efektiviteti i sistemit të arsimit. Në anën tjetër përcaktuesit më vendimtar për efektivitetin dhe efikasitetin e arsimit, sipas të gjitha studimeve (ama bash sipas të gjitha studimeve) meta-analitike, në fushën e pedeutologjisë (teori shkencore që merret me studimin e mësuesve) kanë konstatuar se një ndër faktorët më përcaktues për efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të arsimit janë mësuesit, mësimdhënësit, edukatorët. Andaj, nuk është për t'u befusuar se, qysh në kohërat më të lashta, mësuesi është konsideruar shtylla e kombit.*

Mësimdhënia, si një proces i organizuar njerëzor, është edhe art edhe shkencë. Nëse mësimdhënia nuk është e tillë, ajo nuk do të ndikojë në zhvillimin maksimal njerëzor. Me zhvillim njerëzor nënkuptohet zhvillimi maksimal i potencialeve, aftësive dhe dispozitave të individëve që lidhen me punën, ekonominë, prodhimin (për këtë arsye edukimi dhe arsimimi jo vetëm që konsiderohen, por faktikisht edhe janë, kategoria më propulzive ekonomike); ndërsa me kapital social nënkuptohen proceset që lidhen me krijimin e rrjetave shoqërore, kodeve etike, normave dhe të vlerave humane ndërmjet individit dhe të shoqërisë. Për të realizuar një mësimdhënie të këtillë komplekse në personalitetin e një mësimdhënësit, duhet fuqishëm të gërshetohen edhe aftësitë profesionale (njohja brilante e lëndës, fushës që e zhvillon); por edhe aftësitë maksimale të mjeshtërisë së zejes së mësimdhënies. Me një fjalë, në zhvillimin dhe formimin e mësimdhënësve duhet të punojmë ashtu, që në personalitetin e mësimdhënësit, të zhvillohen: ana **logotrope** (logotropi është njohës i shkëlqyeshëm i shkencës që e zhvillon) dhe ana **pedotrope** (njohje dhe zbatim brilant metodologjive avancuese të mësimdhënies), në mënyrë që përpunimi psikologjik, shkencor dhe didaktik i mësimin, të jetë i tillë, që nxënësit gjatë gjithë kohës sa zhvillohet mësimi të përjetojnë **rezonanca intelektuale**, ose **“aha përjetime”** (siç do thoshte psikologu A. Laj). Vetëm nëse, në mësimdhënësin janë mishëruar të dy këtë aspekte, edhe ajo pedotrope edhe ajo logotrope, mësimdhënësi ka **“locus të brendshëm”** (stabilitet, aftësi, besim, kreacion, qëndrueshmëri) që mund të ndikojë në zhvillimin maksimal njerëzor dhe të kapitalit social.

Qendra për Arsim e Kosovës, deri më tani, më pak ka qenë e angazhuar në zhvillimin e aspektit **logotrop** të mësimdhënësve. Në vijat perspektive zhvillimore, KEC, do të përqendrohet edhe në këtë komponentë, sepse në këtë mënyrë mësimdhënësit e Kosovës do ta kryejnë funksionin e vetë të plotë të edukatorit.

E shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Edukimi për Të Drejtat e Fëmijës

■ Muaji tetor ishte muaji me aktivitete të shumta në fushën e të drejtave të fëmijës. Është punuar mjaft shumë dhe është në përfundim e sipër drafti i Strategjisë Nacionale për të drejtat e fëmijës, i cili do të prezantohet në Konferencën Rajonale e cila do të mbahet në muajin dhjetor të këtij viti, përkatësisht me datën 1 dhe 2 dhjetor.

■ Shkollat fillore të Kosovës gjithashtu janë duke punuar në planet e tyre vjetore në mënyrë që aty të përfshihen aktivitetet të cilat duhet të punohen në kuadër të Komiteteve shkollore për të drejtat e fëmijës.

Në bashkëpunim me Abba-Ceeli-n, KEC, respektivisht projekti “Edukimi për të Drejtat e Fëmijës”, më 25. 10.2006, ka organizuar një vizitë të fëmijëve nga shkollat fillore të komunës së Dragashit, në Gjykatën Komunale të po kësaj komune. Kjo vizitë kishte për qëllim që fëmijët e shkollave fillore të njoftohen për së afërmi me ligjet dhe kodin e të miturve, masat dhe dënimet e të miturve në rast të shkeljes së ligjit. Në këtë takim, po ashtu ishin të pranishëm edhe Zyrtarët dhe Drejtorët Komunal të Arsimit në Komunën e Dragashit dhe të Prizrenit.

■ Në bazë të planit për krijimin e Komiteteve shkollore, ky projekt ka formuar edhe Komitetin Shkollor në shkollën jopublike “Mileniumi i Tretë”. Komiteti përbëhet nga 19 nxënës të kësaj shkolle, të cilët do të punojnë në zhvillimin e aktiviteteve për të drejtat e fëmijëve.

■ Me rastin e Fitër Bajramit, nxënësit e shkollës jopublike “Mileniumi i Tretë”, në

bashkëpunim me projektin “Edukimi për të drejtat e fëmijës”, kanë organizuar një aksion humanitar - përgatitja e pakove me ushqim dhe gjëra higjienike. Këto pako u janë dërguar familjeve me asistencë sociale të cilët ndodhen në Skenderaj, në një ndërtesë kolektive me kushte të këqija për banim.



Qeverisja dhe Udhëheqja në Arsim

■ Më 28/29 tetor në KEC u mbajt trajnimi për trajnerë, pjesa e dytë. Trajnimin e ndoqën vijuesit e gjeneratës së tretë të programit “Qeverisja dhe Udhëheqja e Arsim”. Trajnimi zgjati dy ditë dhe kishte për qëllim përgatitjen e pjesëmarrësve me njohuri dhe teknika të punës në fushën e arsimit të të rriturve dhe në mënyrë specifike, aftësimin e tyre për përgatitjen e moduleve të trajnimit.

Në fazën e tretë që njëherit paraqet fazën e fundit të trajnimit për trajnerë, do të bëhet monitorimi i pjesëmarrësve në vendet e tyre të punës. Kjo do të behët për pjesëmarrësit që janë pjesë e Qeverisjes dhe Menaxhimit në shkolla, ndërsa pjesa tjetër e pjesëmarrësve, që momentalisht nuk janë në pozita udhëheqëse, do të

bëjnë prezantimin e një seance trajnimi para komisionit të caktuar nga KEC.

Pjesëmarrësit që përmbushin kriteret e caktuara do të marrin certifikatë, me të cilën fitojnë titullin Trajner për programin “Qeverisja dhe Udhëheqja e Shkollës”

Programit ACCESS Microscholarship

Zyra Amerikane në Kosovë në partneritet me Qendrën për Arsim të Kosovës, në tetor të këtij viti ka filluar implementimin e Programit ACCESS Microscholarship në Kosovë, program ky që iu mundëson nxënësve mësimin e gjuhës angleze.

Në këtë program janë përfshirë rreth 60 nxënës të shkollave të mesme nga tri regjione të Kosovës: Prishtinë, Prizren dhe Fushë Kosovë.

Mësimi organizohet dy herë në javë me mësues/ekspert amerikan, ku përveç mësimin të gjuhës angleze, nxënësit kanë mundësinë të përfitojnë njohuri, të socializohen dhe shkëmbejnë përvoja me nxënës të nacionaliteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë.

Programi ofron gjithashtu edhe aktivitete të pasura me karakter kulturor dhe rekreativ, si dhe vizita të organizuara në vende të ndryshme brenda Kosovës. Studentët të cilët do të përfundojnë programin dyvjeçar të mësimin të gjuhës angleze do të mbërrijnë një nivel të lartë të zotërimit të gjuhës angleze në kohën e përfundimit të shkollës së mesme.

Ata, gjithashtu do të përfitojnë shkathtësi dhe dije plotësuese për sistemin e arsimit dhe kulturën amerikane. Programit ACCESS Microscholarship zgjatë dy vjet.

Edukimi kundër korrupsionit -EKK

■ Më 6-8 tetor janë mbajtur trajnimet në kuadër të programit EKK në Gjakovë dhe

Prishtinë. Me këto trajnime u përmbyll cikli i trajnimeve për 7 qendrat kryesore të Kosovës, që kishte filluar gjatë muajit shtator. Programi EKK është bashkëpunim i KEC me Balkan Trust for Democracy (BDT) dhe ka për qëllim aftësimin e mësimdhënësve kosovar për të përfshirë idenë e luftës kundër korrupsionit në planprogramin e tyre mësimor. Deri më sot në kuadër të Programit të EKK janë trajnuar mbi 200 mësimdhënës dhe janë certifikuar 29 trajnerë. Mësimdhënësit e përfshirë në trajnim ishin kryesisht të lëndëve shoqërore, sepse këto lëndë kanë hapësirë për të përfshirë brenda njëjësive mësimore idenë e luftës kundër korrupsionit.

■ Pas përfundimit të trajnimeve, mësimdhënësit e përfshirë janë monitoruar në klasat e tyre për të vlerësuar aftësitë e tyre në zbatimin njohurive të fituara gjatë trajnimit. Për trajnerët, organizimi i monitorimit ishte një sfidë mjaft e madhe, për shkak se mësimdhënësit duhej të monitoroheshin gjatë orëve të caktuara kur njëjësia mësimore lejonte përfshirjen e natyrshme të idesë së luftës kundër korrupsionit pa imponim.

Gjatë muajit tetor është përgatitur libri “Edukimi kundër korrupsionit”, i cili do t’iu shpërndahet pjesëmarrësve me rastin e certifikimit.

■ Në 7 qendrat e Kosovës janë përzgjedhur shkollat dhe koordinatorët e Javës së luftës kundër korrupsionit. Gjatë muajit tetor dhe nëntor në këto qendra të Kosovës do të organizohet konkursi për punimet më të mira të nxënësve në letërsi, art figurativ dhe muzikë me temën “Ardhmëria e Kosovës pa korrupsion”. Punimet do të vlerësohen nga komisionet e pavarura dhe nxënësit më të suksesshëm do të shpërblehen.

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit tetor, trajnerët e programit të MKLSH-së që janë duke i udhëhequr seancat e trajnimit për 25 grupet e mësimit që janë duke u trajnuar në kuadër të Programit të MKLSH kanë bërë monitorimin e 750 mësimit në tërë Kosovën. Monitorimi i mësimit është bërë për herë të parë në klasat e tyre me qëllim që të vlerësohet shkalla e përvetësimit të strategjive të reja, si dhe fleksibilitetin e tyre për zbatim në klasë. Çdo monitorim është dokumentuar me fletën e monitorimit që trajnerët kanë plotësuar gjatë vizitës së tyre në shkolla.

■ Rezultatet e monitorimit janë diskutuar gjatë takimit gjysmë-ditor të mbajtur më 14 tetor në 25 qendrat e Kosovës. Trajnerët kanë potencuar se mësimit e përfshirë në trajnim kanë qenë shumë të përkushtuar në zbatimin me sukses të strategjive dhe teknikave të mësuara, në klasat e tyre. Ata vlerësojnë punën e mësimit, por ndërkohë kanë dhënë edhe disa këshilla për të tejkaluar disa nga vështirësitë që janë evidentuar gjatë monitorimit. Më së shumti janë dhënë këshilla se si të organizohet mësimi në klasë gjatë tri etapave të orës ERR duke përfshirë brenda kohës teknikat e ndryshme. Takimi gjysmë-ditor ka qenë rast i mirë edhe për shkëmbimin e përvojës së monitorimit në mes mësimit të përfshirë.

■ Më 21-22 tetor është mbajtur seminari i pestë me titull “Të nxëniet në bashkëpunim” për 25 grupet e përfshira në trajnim. Trajnimi i këtyre grupeve është rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm të KEC me MASHT. Gjithashtu me datë 4 dhe 5 nëntor është mbajtur seminari i gjashtë me radhë me titull “Seminari i shkrimit dhe leximit”, i cili u mbajt në 35 qendra të Kosovës.

■ Gjatë muajit tetor në shkollën fillore “Isa Boletini” në Isniq është mbajtur seminari i katërt në kuadër të Programit të MKLSH për 30 mësimit të kësaj shkolle. Ky program trajnimi mundësohet falë bashkëpunimit të KEC me zyrën e KFOR-it italian në Pejë.

■ Më 28-29 tetor është mbajtur seminari i parë në kuadër të Programit të MKLSH për 40 mësimit të shkollës fillore “Hasan Prishtina” në Prishtinë. Ky trajnim është iniciativë e mësimit të kësaj shkolle të cilët trajnohen me vetëparticipim. KEC për të mbështetur këtë gatishmëri të mësimit për zhvillim profesional ka dhuruar kompletin e udhëzuesve (8 udhëzues) për secilin pjesëmarrës falas. Po ashtu KEC ka aprovuar kërkesën e Gjinnazit “Xhevdet Doda” në Prishtinë për të trajnuar 35 mësimit të kësaj shkolle në kuadër të Programit të MKLSH-së. Seminari i parë do të fillojë në 18-19 nëntor, ndërsa do të përfundojë në qershor të vitit të ardhshëm.

Hap pas Hapi

■ Më 2 -5 tetor 2006 u mbajt trajnimi për të drejtën shoqërore. Trajnimin e udhëhoqën dy trajnerë ndërkombëtarë Peter Repisky – Sllovakia dhe Nancy Jane Smith – ShBA. Ky trajnim ishte pjesa e dytë e trajnimit që ka filluar më herët. Trajnimin e ndoqën 15 pjesëmarrës. Gjatë dhjetorit do të mbahet edhe pjesa e tretë e këtij trajnimi.

■ Në datat 6,7, 8, 14, 15 tetor është mbajtur trajnimi bazik për parashkollor në të cilin morën pjesë 30 edukatorë. Trajnimi është kryer nga trajnerë vendor.

■ Më 20, 21, 22 tetor u mbajt trajnimi për klasën e parë, ku morën pjesë 28 mësues. Trajnimi është kryer nga trajnerë vendor.

■ Më 27, 28, 29 tetor, si dhe me 4, 5 nëntor u mbajt trajnimi bazik për klasën e parë.

Në këtë trajnim morën pjesë 3 grupe nga pjesë të ndryshme të Kosovës (Gjakova me rrethinë, rajoni i Mitrovicës dhe rajoni i Podujevës).

Grupi nga Gjakova, trajnimin e mbajti në Qendrën Didaktike në Gjakovë, ndërsa grupet tjera nga Mitrovica dhe Podujeva trajnimin e mbajtën në lokalet e KEC. Këtë trajnim e ndoqën rreth 100 mësimitdhënës.

Strategjia e arsimit parauniversitar

■ Në kuadër të diskutimit publik të draftit të Strategjisë Parauniversitare 2007 - 2017 janë mbajtur 7 diskutime publike në qendra të ndryshme të Kosovës. Në këto diskutime, nga ana e pjesëmarrësve janë dhënë vërejtjet dhe sugjerime, të cilat do t'i shqyrtoj Grupi i ekspertëve.



■ Me datën 10–11 nëntor do të mbahet Konferenca Ndërkombëtare për Strategjinë e arsimit parauniversitar në Kosovë. Në këtë Konferencë pritet të marrin pjesë ekspertë ndërkombëtarë dhe vendor të arsimit parauniversitar.

Strategjitë e reja të mësimitdhënies dhe të nxënimit

■ Gjatë muajit tetor KEC në bashkëpunim me NJMP të Bankës Botërore ka filluar trajnimin e 300 mësimitdhënësve në 10 vende të Kosovës: Rahovec, Gjakovë, Gjilan, Kamenicë, Prizren, Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Suharekë dhe Ferizaj. Ky program është version i shkurtuar i Programit të MKLSH-së, i cili zgjatë 10 ditë dhe mbulon 6 udhëzuesit e Programit të MKLSH-së. Dy seminarët e para për 10 grupet janë mbajtur më 7-8 tetor përkatësisht 14-15 tetor. Monitorimi i parë në klasë i pjesëmarrësve është bërë në gjysmën e dytë të muajit tetor. Udhëheqësit e trajnimeve kanë mbajtur takimet gjysmë-ditore për të prezantuar para pjesëmarrësve rezultatet e monitorimit. Seminari i tretë do të mbahet më 4-5 nëntor 2006.

Shkolla “Mileniumi i Tretë”

■ Më 16 tetor 2006, u mbajt java e parë e projekteve për Vitin e ri shkollor 2006/2007.

Gjatë kësaj jave nxënësit e klasave të ndryshme (klasat e pesta, të gjashta dhe të shtata) të ndarë në grupe kanë punuar në tema të ndryshme, përkatësisht në projekte të ndryshme. Nxënësit kanë pasur mundësitë që të vendosin për projektet në të cilat ata kanë dëshirë të marrin pjesë. Gjithashtu, është bërë harmonizimi i qëndrimeve për temat e projekteve dhe ndërlihdjen e lëndëve të ndryshme brenda një projekti.

Projektet kanë përfunduar të premtën kur edhe është bërë prezantimi i tyre.

Përgatiti: Petrit Tahiri